



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			
CAA			
Nr. i prot. 2018/ZDP/56			
Br. prot./Prot. br.			
Faqe: 2	Kopje: 1	Datë: 21/12/2018	
Stranica/Pages	Kopije/Copy	Datum/Date	
Civil i Kosovës	<input type="checkbox"/>		
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova	<input checked="" type="checkbox"/>		
Civil Aviation Authority of Kosovo	<input type="checkbox"/>		
Prishtinë/Prishtina/Pristina			

Nr. ref: 19/ZDP/VE/2018

Datë: 21 dhjetor 2018

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, 10 shkurt 2016, dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 28 prill 2014),

Në përputhje me nën-nënparagrafin 8.4.2 (b) të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës të AAC-së,

Zëvendës Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

VENDIM

1. Përcaktohet tarifa njësi terminale për vitin 2019 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 378 EUR.
2. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) për shërbimet terminale të navigacionit ajror që kjo ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari") duke filluar nga data 1 janar 2019.
3. Ky Vendim hyn në fuqi më 1 janar 2019.

ARSYETIM

Duke marrë parasysh që:

- Autoriteti i Aviacionit Civil ka përfunduar shqyrtimin rregullator të propozimit të ASHNA-s për koston finale të ofrimit të shërbimit gjatë vitit 2019 dhe përcaktimin final mbi këtë kosto e ka bërë përmes Vendimit të tij nr. 18/ZDP/VE/2018 dt. 7 dhjetor 2018; dhe
- ASHNA ka kryer procesin e obligueshëm të konsultimit me kompanitë ajrore në periudhën 12 nëntor - 3 dhjetor 2018 për propozimin e tarifës njësi terminale për vitin 2019;

Zëvendës Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Prishtinë, 21 dhjetor 2018

Xhelil Bekteshi
Zëvendës Drejtor i përgjithshëm



Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur mund të ngre padi për konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente 30 ditë nga pranimi i këtij Vendimi. Ngritja e padisë nuk e pezullon ekzekutimin e këtij Vendimi.

Iu dërgohet:

- Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror
- Ministrit të Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, Ministria e Financave
- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"